



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development

Në bazë Ligjit nr. 03/L-189 mbi Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr 82, 21 tetor 2010) dhe Nenin 13 të Rregullores MF – Nr. 02/2013 – për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, lidhet kjo;

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

Në mes të

MINISTRISË TË ZHVILLIMIT EKONOMIK

dhe

KOMUNËS TË MITROVICËS

Për transferin e pasurisë jo-financiare;

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (në tekstin e mëtejshëm MZHE) dhe Komuna e Mitrovicës (në tekstin e mëtejshëm: Përfituesi), janë pajtuar për transferin e pasurisë jofinanciare: Pajisje teknologjike për projektin, “Furnizimi me pajisje të teknologjisë së informacionit për shkollat e mesme - Qendrat Kreative” LOT I dhe LOT II, me numër indentifikues 213/18/009/111 konform Rregullores MF – Nr. 02/2013 – për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore.

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

1. Projekti: “Furnizimi me pajisje të teknologjisë së informacionit për shkollat e mesme - Qendrat Kreative” LOT I dhe LOT II, me numër indentifikues 213/18/009/111, i implementuar në vitin 2018 në shkollat e Komunës së Mitrovicës:

- 1.1. SH.K. Teknike “Arkitekt Sinani”, Mitrovicë;
- 1.2. Gjinnali “Frang Bardhi”, Mitrovicë;
- 1.3. SH.M Ekonomike “Hasan Prishtina”, Mitrovicë;



2. Vlera e financimit në Shkollat e sipërpërmendura është, 27048.18 Euro.

Neni 2

Përgjegjësitë e palëve

1. Përfituesi merr në pronësi pasurinë jo-financiare nga Nenin 1 i kësaj Marrëveshje.
2. MZHE, me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës në institucionet arsimore, i transferon përfituesit pajisjet teknologjike dhe inventarin sipas fletëdërgesave Lot 1 dhe Listës së pajisjeve dhe inventarit të dorëzuar.

Neni 3

Menaxhimi dhe mbikëqyrja e projektit

1. Përfituesi merr në pronësi dhe menaxhim të plotë dhe pa kurrfarë kufizimesh pasurinë jo-financiare nga Objekti i Marrëveshjes (Secila pjesën e vet nga Neni 1, pika 2 e marrëveshjes).
2. Përfituesi do ta ketë në pronësi të gjithë dokumentacionin që bën të formalizuar projektin nga Objekti i Marrëveshjes;
- 3.1. Kontratat dhe urdherpagesa;
- 3.2. Faturat e projektit, urdherblerja dhe raporti pranimit;
- 3.3. Fletëdërgesat.

Neni 4

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do t'i zgjidhin mosmarrëveshjet eventuale që kanë ndërmjet veti përmes mirëbesimit ose bisedimeve të përbashkëta.

Neni 5

Ndryshimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e nënshkruesve të Marrëveshjes.



Neni 7

Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje të zbatohet nga dita e nënshkrimit të saj.

Në emër të:

Në emër të:

Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik

Nazmi Zenelaj, Sekretar i Përgjithshëm



Komunës së Mitrovicës

Agim Bahtiri, Kryetar



Prishtinë;

Data e nënshkrimit; 20.12/2018

